FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK - KGF

PRISHTINË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRRMJET

"FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS", PRISHTINË, KOSOVË

DHE

"KOLEGJIT AAB- FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT ", PRISHTINË, KOSOVË

Qëllimi i bashkëpunimit

Palët e sipërpërmendura janë të interesuara të nënshkruajnë këtë marrëveshje duke u bazuar në parimin e ruajtjes së vlerës dhe rritjes së mirëqenës shoqërore, respektivisht ofrimin e njohurive të reja për studentë.

Përmes këtij bashkëpunimi synohet:

1. Zhvillimi i bashkëpunimit të ngushtë midis **"Federatës së Gjimnastikës të Kosovës", Prishtinë, Kosovë dhe "KOLEGJIT AAB- Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit", PRISHTINË, KOSOVË**, duke u bazuar në përcaktimin e programeve të përbashkëta në realizimin e pjesës praktike të studentëve, për mbrojtjen e interesit të studentëve, për zhvillimin e njohurive të reja respektivisht atyre praktike, në kuadër të lëndës së Gjimnastikës.
2. Shkëmbimin e stafit akademik dhe profesional,
3. Organizimin e përbashkët të konferencave shkencore, seminareve, tryezave dhe pjesëmarrjen në takime të ndryshme;
4. Shkëmbimin e materialeve profesionale si dhe informacioneve të tjera të nevojshme;
5. Shkëmbimin e literaturës profesionale në mes të dy palëve,
6. Programe të veçanta akademike afatshkurtra, përfshirë organizimin e përbashkët të shkollave verore, kampeve të ndryshme, manifestimeve të ndryshme, garave të niveleve të ndryshme
7. Licencimin e studenteve për trajner të Gjimnastikës. (Me kompensim sipas marrëveshjes për punë profesionale të kryer nga Federata).

8. Shkëmbim të përvojave me synim të fuqizimit të politikave edukativo – arsimore, sociale, emancipimin dhe afirmimin e vlerave të mirëfillta të studentëve.

9. Kjo marrëveshje do të jetë e plotë fuqishme (do të hy në fuqi), menjëherë pas nënshkrimit te palëve përkatëse. Ajo mund të modifikohet në çdo kohë më pëlqimin e palëve. Nëse njëra palë nënshkruese e marrëveshjes, për çfarëdo arsyeje dëshiron të tërhiqet nga marrëveshja, ajo duhet të lajmëroj palën tjetër jo më pak se një muaj përpara.

10. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e një natyre tërësisht rekomanduese. Ajo nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.

11. Për çdo marrëveshje lidhur me realizimin e punëve në detaje, palët do të hartojnë një marrëveshje shtesë.

6. Orari i praktikës së studentëve caktohet në bashkëpunim me Kolegjin AAB, studentin/en dhe Federatën.
7. Aplikimin e përbashkët për fonde vendore e ndërkombëtare në fushën e Gjimnastikës.
8. Forma të tjera të bashkëpunimit.

Studenti zotohet për obligimet që dalin nga marrëveshja e përbashkët:

a) Gjatë tërë kohës do të sillem sipas rregullave dhe përgjegjësive si bartës i praktikës;

b) Do të mbajë konfidente të gjitha informatat e pa publikuara, që mund t'i marr gjatë kryerjes së praktikës dhe aktiviteteve tjera dhe nuk do të publikoj, ndonjë raport bazuar në informatat që mund t'i marr gjatë angazhimit;

c) Të lajmëroj profesorin/instruktorin dhe ndërmarrjen/qendrën sportive në rast të sëmundjes, ose rrethanave të tjera që mund të më pengojnë në përmbushjen e obligimeve të mia.

Ndërsa Federata e Gjimnastikës të Kosovës zotohet se do:

a) Të krijojë kushte dhe ofrojë mjete/pajisje të nevojshme, për kandidatin gjatë kryerjes së praktikës profesionale dhe aktiviteteve tjera në ambientin e federatës apo diku tjetër.

b) Të emërojë ndonjë nga punëtorët me përvojë, që të mbikëqyrë dhe ndihmojë studentin gjatë praktikës profesionale;

c) Federata deklaron se pajtohet në përmbushjen e të gjitha detyrimeve, që parashihen në Marrëveshjen e Mirëkuptimit;

d) Të plotësoj formularin e praktikës profesionale të studentit, që është i hartuar nga Kolegji AAB, dhe atë marrëveshje ta posedojnë edhe studentët.

e) Kjo marrëveshje është e vlefshme më nënshkrimin e të gjitha palëve të përfshira në proces.

9. Mos përmbushja e obligimeve të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshje-Bashkëpunimi është bazë për prishjen e së njëjtës.
10. Marrëveshja është hartuar në 2 (dy) kopje, për secilën palë nga 1 (një).

Kontaktet:

Përfaqësuesi i Federatës:

Besim Halilaj, Kryetar

Nr. Tel: +38344 243 636

Email: info.kosova.gym@gmail.com

Përfaqësuesi i Kolegjit AAB:

Prof. Asoc. Dr. Fatmir Pireva

Nr. Tel: +383 44 118 601

Email: fatmir.pireva@aab-edu.net

Me nënshkrim të marrëveshjes, palët konfirmojnë se i kanë lexuar me kujdes, i kanë të qarta dhe i kanë kuptuar në tërësi obligimet, dhe marrin përgjegjësi për të gjitha pikat në këtë marrëveshje.

Nënshkrimi i Marrëveshjes nga palët përkatëse:

KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE
Prishtinë
Nr. 249 data: 05.04.2022

Kolegji AAB

(përfaqësuesi)

FATMIR PIREVA

Emri dhe Mbiemri

DEKAN

Profili

Nënshkrimi

Federata e Gjimnastikës e Kosovës

(përfaqësuesi)

BESIM HALILAJ

Emri dhe Mbiemri

KRYETARË

Pozita

BHalilaj

Nënshkrimi

Prishtinë, 05.04.2022